



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt. 22.04.2024, në ora 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi, Ajshe Haliti Pllana, Sami Ahmeti, Bajram Hashani, Labinot Mirena dhe Nazlije Shala

Të pranishmit tjerë: përf, e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e Komitetit e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloj mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Raportit finansiar të shpenzimeve për periudhën janar - mars 2024, dhe Raportit për subvencionet sipas Drejtoreve
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të NPL "Kastrioti" SH.A. për vitin 2023
5. Shqyrtimi i kërkesës për ngritje të tarifës për shërbimet e menaxhimit të mbeturinave
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 6 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët e Komitetit ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 6 vota për.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e Raportit finansiar të shpenzimeve për periudhën janar-mars 2024, dhe Raportit për subvencionet sipas Drejtoreve.

Enver Gashi – Ne si grup parlamentar jemi që kjo pikë e rendit të ditës të kaloj në Kuvend dhe nëse, atje kemi diçka do ta japim kontributin tonë.

Ajshe Haliti Pllana – Edhe ne jemi për që ky raport të shkoj në Kuvendin Komunal.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota për ia rekanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin e Raportit finansiar të shpenzimeve për periudhën Janar – Mars 2024, dhe Raportit për subvencionet sipas Drejtoreve.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e Raportit vjetor të NPL ”Kastrioti” SH.A. për vitin 2023. Ju njoftoj se para se të filloj mbledhja e KPF-së, thirri Kryeshefi i NPL ”Kastriti” dhe Kryetari i aksionarëve të cilët kërkuan falje për mospjesëmarrje në mbledhje për arsy se kishin një aktivitet për mbjelljen e luleve me Kryetarin që po fillonte në ora 11:00 por që patjetër në mbledhjen e Kuvendit do të vijnë.

Enver Gashi – Është mirë që raporti ka ardhë me kohë dhe ne si raport e kemi shqyrtue që mendoj se është raport i mirë dhe në mbledhjen e Kuvendit kur të jenë edhe përfaqësuesit prezantë ku edhe do të debatojmë.

Ajshe Haliti Pllana – Edhe ne jemi për që ky raport të shkoj në Kuvend.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin e Raportit vjetor të NPL ”Kastrioti” SH.A. për vitin 2023.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës për ngritje të tarifës për shërbimet e menaxhimit të mbeturinave.

Enver Gashi – Ne e dijmë që kjo taksë është pak e vogël për punën që e bëjnë këta dhe e kemi pasë një iniciativë më heret për ngritjen e kësaj takse, por nuk ka qenë e harmonizuar me regjion. Komuna e Obiliqit është në mes të Prishtinës, Fushë Kosovës, Drenasit, Podujevës dhe Vushtrrisë, kështu që sidomos në regjion nëse nuk ka harmoni të çmimeve nuk është mirë dhe meqë, Prishtina tashmë e ka aprovue këtë tarifë ne jemi për që kjo kërkesë të shkoj në Kuvend dhe të aprovohet në vlerën prej 6.20 euro.

Sami Ahmeti – Ne për këtë pikë patëm bissdue edhe kur është bë Rregullorja në tërësi para 1 viti e gjysmë dhe përvèç asaj për me mbulue këtë kuotë që ne pajtohem që është kuotë e ulët, por megjithatë nuk jemi për me rëndue më tepër xhepin e qytetarëve. Ne i patëm bë disa propozime të cilat sigurisht se do ti cekim edhe në seancë, por asnjë prej atyre propozimeve që janë bë në Rregullore që ka pasë të bëjë me obligimin e se cilës prej ekonomive familjare të kyqen në sistemin e mbledhjes së mbeturinave nuk ka shkue para. Mirëpo, po shkojmë nga ajo forma më e lehtë direkt me iu kërkue qytetarëve tarifa më të larta, ne jemi kundër dhe do ta vërtetojmë këtë edhe në seancë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 5 vota për dhe 2 vota kundër ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin e kërkesës për ngritje të tarifës për shërbimet e menaxhimit të mbeturinave.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesja – Meqë, nuk kemi pranuar asnjë kërkesë për shqyrtim as nga qytetarët, as nga Ministritë kalojmë në pikën e radhës.

Pika 7 e rendit të ditës

Sami Ahmeti – E kemi cekë disa herë çështjen e ndriçimit publik dhe sot e kam një kërkesë edhe më të ngushtë në raport me ndriçimin publik. Banorët e lagjes time ortakollit mua po më kërkojnë në njëfarë mënyre llogari se a është faji yt që vetëm ajo rrugë ka mbetë jashtë sistemit të ndriçimit. Ndërsa, sot unë e kam një kërkesë nëse, nuk bëjmë shkelje ligjore unë e marrë përgjegjësinë me mjetet e mia i rregulloj ato drita që janë prish në lagjen tonë sepse nuk dua që banorëve me iu bë telashe, pasi veç kështu hapur po duket se është e qëllimshme.

Kryesuesja – Pyeti a është i vendosur rrjeti.

Sami Ahmeti – Po është i vendosur rrjeti dhe janë prish dikund mbi 60-70 % të drิตave, që ndoshta është më mirë me u ndalue si drita sepse ato vetëm po blinkojnë vazhdimeshit bile, kush udhëton në këmbë ua prishin sytë. Unë nuk e kam problem edhe me financat e mia mund ti rregulloj vetëm se nuk dua të bëjë shkelje ligjore sepse është pronë publike dhe nuk dua të ndërhyj. Ajo po duket haptas për çka është por pa dashur me i dhënë konotacion tjetër kisha pasë dëshirë me marrë një përgjegje prej Drejtorisë, jo vetëm për atë rrugë sepse ka edhe rrugë tjera, mirëpo kjo te unë është ky problem.

Kryesuesja – Ne menjëherë pas mbledhjes do ta adresojmë pyetjen te Drejtoria përkatëse

Mbledhja përfundoi në ora 11:18'

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli

